



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.4, datë 21.11.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE”
SUBJEKTIT “R.B.H BELINE”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, subjektit “R.B.H Beline”, me vendndodhje Njësia Administrative Bradashesh Elbasan Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- X= 500656.518; Y= 4550071.94; Z= 94.48 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shfrytëzimit sipas KRGJSH

- X= 500628.61; Y= 4550108.471; Z= 94.2 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shkarkimit sipas KRGJSH

- $X= 500769.576$; $Y= 4550137.025$; $Z= 92.9$ m.m.n.d

- Prurja e kërkuar: $Q= 3.6$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

